



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI PORTUAL DURRËS

PROCES-VERBAL - Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky proces-verbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

- F/V – Shpenzime për Infrastrukturën Civile

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Punë ndërtimi 45000000-7

VLERA E FONDIT LIMIT:

- 5,110,063 (pesë milion e njëqind e dhjetë mijë e gjashtëdhjetë e tre) lekë, pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës, ka hartuar proces-verbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1 Oferta ekonomike

Operatori ekonomik duhet të dorëzojë preventivin me volumet si vijon dhe çmimi total i tij duhet të përkohë me vlerën e ofertuar. Pagesat do të kryhen sipas çmimeve njësi dhe volumeve të punimeve të realizuara të miratuara nga mbikëqyrësi dhe pranuar nga Autoriteti Kontraktor sipas legjislacionit për ndërtimet në fuqi. Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën e përzgjedhjes së ndërhyrjeve që do të realizohen brenda kufijve të volumeve të parashikuara.

PREVENTIV (për tu plotësuar nga operatori ekonomik)

Nr.	Nr.An.	Emërtimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
1	2	3	4	5	6	7=5x6

A Hidroizolim Tarace ADM2

1	2.197 (60%)	Shkepje Hidroizolimi me karton katrama egzistues	m2	620		
2	2.264(60%)	Shkepje shtrese lluster çimento.2 cm	m2	620		
3	2.331 (60%)	Shkepje suva e zakonshme fasade mur tulle ~ 8m	m2	30		
4	2.197	Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 k katrama	m2	620		
5	2.264	Shtresë llustër çimento 1:2(trashesia 2 cm)	m2	620		
6	2.203/a	Veshje korrnize llamarine bakri t = 0.8 mm	m2	85		
7	2.206/b	Kasete shkarkimi me llamarine bakri 1.0mm	cope	6		
8	2.209/b	Ulluk shkarkimi vertikal me baker Φ 120	ml	50		

B Riparime Zyrrat ADM2 Kati i Dyte

1	2.375	Heqje/Dritare d/alumini tek xh.	m2	36.5		
2	2.388/1 (60%)	Heqje/ dyer te brendeshme tamburate te rimesuara	m2	18		
3	2.266 (60%)	Heqje/ Shtrese me pllaka granili te zakonshme, 30x30cm	m2	135		
4	2.267b	Shtrese me pllaka grez importi, 40x40cm	m2	135		
5	2.324a	Plintuse pllake grez	ml	122		
6	2.375/1	F V dritare d/alumini plastike me dopio xham	m2	33.5		
7	2.383/1	F V dyer te brendeshme druri importi cilesi e	m2	18		
8	2.395	Dyer d/alumini tek xham.	m2	4.5		
9	2.310	Suva brenda mur tulle h~4m me krah, llaç	m2	60		
10	2.328	Patinim muri allçi (stuko)	m2	60		
11	2.404/1	Boje hidroplastike importi cilesi e l-re	m2	1050		

C Riparime Zyrrat e reja ASDC

1	2.297/b	F/V Veshje muri me kartonxhes	m2	76		
2	2.297/b	Prishje 60% e op se veshjes *60% e 278l	m2	44		
3	2.404/1	Boje hidroplastike cilesi e larte	m2	393		
4	2.297/b	F/V Tavan i varur me pllaka gipsi 60x60cm	m2	50		
5	2.383/1	F/V Dyer te brendeshme druri importi cilesi e l-re.	m2	15		
6	2.373	F/V Vetrato xhami i temperuar	m2	30		
7	2.284	Shtrese parketi laminat	m2	40		

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim, të lëshuar nga Administrata Tatimore, për xhiron vjetore për vitet financiare (2020-2021-2022), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit.

Vlera e fondit limit është referuar preventivit të projektit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, si dëshmi për përvojën e mëparshme, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi për përvojën e mëparshme, duhet të paraqiten, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Dëshmitë dhe vërtetimet e kërkuara do të plotësohen sipas shtojcës 9 shoqëruar me kontratë, situacione dhe akt-kolaudimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4 a), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.2 Mbi liçencat profesionale

Subjektet zbatuese, pjesmarrëse në konkurim duhet të zotërojnë, Liçenca profesionale të Zbatimit, referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”:

- NP – 3 A Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile dhe industriale;
- NS – 1 A Punime per prishjen e ndertimeve;
- NS – 4 A Punime rifiniture dhe të lidhura me to, ...;

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomik, liçencat profesionale duhet ti paraqesë operatori ekonomik që ka marrë përsipër punimet për të cilat kërkohet liçencat profesionale.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktues dhe Energjise, (ose Ministrise kompetente te kohes) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). Mosparaqitja ne kete forme eshte kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe VKM- nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” i ndryshuar, projekt-preventivin e projektit, VKM nr. 629, datë 15.07.2015, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” i ndryshuar, Udhëzim nr.3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”.
(Shënim: përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor që parashikon licencimin në fushën e zbatimit të punimeve të ndërtimit, kategoritë e nevojshme të licencës, me emërtimin e tyre në përputhje me legjislacionin e fushës, duke përcaktuar edhe nivelin minimal të klasifikimit për çdo kategori, sipas vlerave të punimeve konkrete që do kryhen, si dhe institucionin që lëshon këtë licencë).

2.3.3 Mbi stafin inxhinierik

Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë në pjesë të stafit, ekspertët e poshtëshënuar:

1 (nje) Inxhinier ndërtimi,

Stafi i mësipërm duhet të jetë pjesë e drejtuesve teknikë të shoqërisë, të figurë në listë pagesën e muajit të fundit (.....), dhe për to duhet të dorëzohen CV-të, kontratë pune, diplomë, dhe liçencat profesionale individuale.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtim është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët

ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

2.3.4 Mbi fuqinë punëtore

- Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij të punësuar:

Punonjës suvaxhi	3 (tre)
Punonjës Hidroizolues	2 (dy)
Punonjës Bojaxhi	2 (dy)
Punonjës Elektricitë	2 (dy)
Punonjës Pllakashtrues	2 (dy)
Punonjës Punime gips	2 (dy)
Punonjës Punime duralumini/pvc	1 (një)

Për përmbushjen e këtij kushti, kërkohet që operatorit ekonomik, duhet të paraqesë për punonjësit specialist si dokumente provues: kontratë pune të vlefshme, dëshmi kualifikimi dhe dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (të vlefshme), kartela personale të sigurimit Teknik, të lëshuara nga organe kompetente në bazë të Ligjit Nr. 8734, datë 01.02.2001 dhe Ligji Nr. 13/2013, si dhe të figurojnë në listpagesat për periudhën Janar 2023 – Mars 2023.

Operatori Ekonomik duhet të vetëdeklarojë (sipas Shtojcës 8 të DST) se disponon fuqinë minimale punëtore jo më të vogël se 15 (pesëmbëdhjete) punonjës të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit për periudhën Janar 2023 – Mars 2023.

Argumentimi: Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës etj. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje gjashtë muajt e fundit, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës (Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore).

2.3.5 Makineri dhe paisje

Nr.	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Kamioncine	Në pronësi ose me qera	Copë	1
2	Kamion vetshkarkues me vinç, kapacitet mbajtes min 3 ton.	Në pronësi ose me qera	Copë	1
3	Elektro - Betoniere	Në pronësi ose me qera	Copë	1
4	Matrapik	Në pronësi ose me qera	Copë	1
5	Gjenerator	Në pronësi ose me qera	Copë	1

Ky dokumentacion, përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST-së.

Ofertuesi për makineritë, të cilat janë në pronësi ose me qera, duhet të paraqesë, dokumentacionin e mëposhtëm:

A. Për mjetet në Pronësi që shënohen në Rregjistra Publikë, duhet të paraqiten:

1. Çertifikatë mbi Pronësinë e mjetit rrugor, lëshuar nga D.P.SH.T.RR.
2. Leje qarkullimi, të vlefshme, lëshuar nga D.P.SH.T.RR.
3. Çertifikata e kontrollit teknik të mjeteve rrugore, të vlefshme, lëshuar nga D.P.SH.T.RR.
4. Police për sigurimin e detyrueshem ndaj palëve të treta (T.P.L), të vlefshme, lëshuar nga njëra prej Kompanive të Sigurimit që operojnë në tregun shqiptar.

B. Për mjetet me Qera që shënohen në Rregjistra Publikë, duhet të paraqiten:

1. Çertifikatë mbi Pronësinë e mjetit rrugor, lëshuar nga D.P.SH.T.RR.
2. Leje qarkullimi, të vlefshme, lëshuar nga D.P.SH.T.RR.
3. Çertifikata e kontrollit teknik të mjeteve rrugore, të vlefshme, lëshuar nga D.P.SH.T.RR.
4. Police për sigurimin e detyrueshem ndaj palëve të treta (T.P.L.), të vlefshme, lëshuar nga njëra prej Kompanive të Sigurimit që operojnë në tregun shqiptar.
5. Kontrata përkatëse e qerasë, e vlefshme për të paktën periudhën e zbatimit të Kontratës.

C. Për mjetet në Pronësi që nuk shënohen në Rregjistra Publikë, duhet të paraqiten:

1. Fatura tatimore e blerjes, akt çdoganimi për mjetet e importuara.

D. Për mjetet me qera që nuk shënohen në Rregjistra Publikë, duhet të paraqiten:

1. Fatura tatimore të blerjes, akt çdoganimi për mjetet e importuara;
2. Kontrata përkatëse e qerasë, e vlefshme për të paktën periudhën e zbatimit të Kontratës.

2.3.6 Mjete dhe paisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” i ndryshuar, si më poshtë vijon duhet të disponojë :

- Kokore mbrojtese, minimumi 10 copë;
- Jeleke Fosforeshente, minimumi 10 copë;
- Fikëse zjarri të lëvizshme, minimumi 2 copë;
- Prozhektorë ndriçimi natën, minimumi 2 copë;
- Karroca dore, minimumi 2 (dy) cope;
- Kompletet ndimës së shpejtë, minimumi 2 copë;
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt, minimumi 2 copë.

Është e mjaftueshme paraqitja e vetëdeklarimit sipas Shtojcës Nr.8 të DST-së.

Autoriteti Kontraktor, rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të vetëdeklaruar (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese) sipas Shtocës Nr. 8 të DST-së. Në rast deklarimi të rremë, do të veprohet në përputhje të Ligjit Nr.162/2020 datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

Operatori/et ekonomik ofertes, duhet të deklarojë, që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara, do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera, afati i zbatimit të të cilave shtrihet përgjatë afatit të kontratës objekt prokurimi, janë shkak skualifikimi. Autoriteti Kontraktor, gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve, si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në rast deklarimi të rremë, do të veprohet në përputhje të Ligjit Nr.162/2020 datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, projekt-preventivin e projektit, VKM nr. 629, datë 15.07.2015, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” i ndryshuar, grafikun e realizimit të punimeve dhe përcaktimëve të tjera të projektit.

2.3.7 Mbi çertifikimet e kompanisë

- Çertifikatë EN-ISO 9001-2015 ose ekuivalenti i tij (Sistemi i menaxhimit të cilësisë, e vlefshme). Në rastë bashkimi të OE, duhet të plotësohet nga secili prej anëtarëve në varësi të natyrës së zërave të punës të marrë sipas Akt – Marrëveshjes së Bashkëpunimit).
- Çertifikatë EN-ISO 14001-2015 ose ekuivalenti i tij (Sistemi i menaxhimit të mjedisit, e vlefshme). Në rastë bashkimi të OE, duhet të plotësohet nga secili prej anëtarëve në varësi të natyrës së zërave të punës të marrë sipas Akt – Marrëveshjes së Bashkëpunimit).
- Çertifikatë EN-ISO 45001-2018 ose ekuivalenti i tij (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, e vlefshme). Në rastë bashkimi të OE, duhet të plotësohet nga secili prej anëtarëve në varësi të natyrës së zërave të punës të marrë sipas Akt – Marrëveshjes së Bashkëpunimit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në bazë të nenit të 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe Ligjit 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që plotësojnë kërkesat e cilësisë për realizimin me sukses të kontratës. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto çertifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pranohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës sipas praktikave me të mira për mjedisin duke pasur punime që gjenerojnë inerte dhe mbetje të tjera nga materialet e ndertimit si dhe sigruine e cilesise se punimeve me standarte te sigurimit teknik dhe mbrotjen ne pune te punetorise qe do marre pjese ne keto punime. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë çertifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

OPERATORI/ËT EKONOMIK OFERTUES DUHET TË PARAQESIN:

5.1 Grafikon e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit (Bashkëlidhur DST-së), të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit.

5.2 Planin e organizimit të punimeve.

5.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori për: materialet elektrike, boje hidroplastike, materiale hidroizoluese, pllakë shtrimi grez porcelanato, dhe parket laminat. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit.

Argumentim: Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet . Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

5.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog /skedë teknike për materialet elektrike, boje hidroplastike, materiale hidroizoluese, pllakë shtrimi grez porcelanato, dhe parket laminat.

Argumentim: Ky kriter është menduar për të dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to. Kriteri i kërkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, është vendosur në përputhje me pikën 6/b, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

5.5 Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me standardet e kërkuara operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion justifikues (certifikata/deklarata prodhuesi/test raporte) për standardet dhe kërkesat që duhet të përmbushin zërat e kërkuara në formularin e specifikimeve teknike.

Argumentim: Ky kriter është menduar për të dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to. Kriteri i kërkuar është vendosur në përputhje me pikën 6/c, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për mallrat objekt procedure prokurimi, duke përlogaritur sasitë e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”